



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I NDIHMËS DHE KOORDINIMIT TË INFORMACIONIT**

Nr. 1536 Prot.

Tiranë, më 12 . 05 .2026

NJOFTIM ME SHPALLJE

**TË VENDIMIT NR. 3535/1 PROT., DATË 06.02.2026 TË INSPEKTORIT TË
LARTË TË DREJTËSISË, “PËR PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS
ADMINISTRATIVE PA NJË VENDIM PËRFUNDIMTAR DHE ARKIVIMIN
PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA
SHTETASI Z. VELI MEHAJ**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga z. Veli Mehaj me nr. 2297 prot., datë 21.08.2024, në të cilën ngrihen pretendime për veprimtarinë e magjistratëve A.D., E.M., dhe B.H., me detyrë gjyqtarë pranë Gjykatës Administrative të Apelit, si dhe ndaj magjistratëve A.A., A.V., dhe G.M., me detyrë gjyqtarë pranë Gjykatës së Lartë, në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur dhe me vendimin nr. 3535/1 prot., datë 06.02.2026, “Për përfundimin e procedurës administrative pa një vendim përfundimtar dhe arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Veli Mehaj”, bazuar në nenin 121, pika 2, shkronja “a”, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 95 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ka vendosur arkivimin e saj. Vendimi duhet t’i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e deklaruar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Tiranë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Rruga “Luigj Gurakuqi”, “CLO Shop”, Kinostudio, Tiranë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

